

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtarja e vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në lëndën penale kundër të akuzuarëve A.C. nga .... për shkak të veprës penale penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, M.K. dhe N.J. që të dy nga ....., për shkak të veprës penale: në bashkëveprim si bashkekzekutor pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.1850/2013, të dt.01.10.25013, më datë 16.06.2016 shpalli dhe komunikoi publikisht, më datën 16.06.2016 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.A.C., në bazë të evidencës që posedon kjo gjykatë i pa dënuar më parë për veprë tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale ( koha e kaluar në paraburgim prej datës 12.09.2013 deri më datë 02.10.2016) .

2.N.J., në bazë të evidencës që posedon kjo gjykatë i pa dënuar më parë për veprë tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale .

**I akuzuari A.C.**

Është fajtor

Më datën 12.09.2013, rreth orës 00.45 h, në .... , në kafiterin “ ...” , e ka sulmuar personin zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare lidhur me sigurinë e përgjithshme në ruajtjen e rendit publik, në atë mënyrë që pa asnjë arsye e godet me grusht në fytyrë mbi vetullën e majtë zyrtarin e policisë së ..... S.S.. në kohën deri sa i njëjti ka qenë duke e kryer detyrën e vet zyrtare dhe me këtë rast të njëjtit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore në formën si ato janë përshkruar në raportet mjekësore me nr.3212 dhe 17770 të dy raportet e datës 12.09.2013 , njëri i shtëpisë së shëndetit në ..... dhe tjetri i Emergjencës së Spitalit Regjional në .....

- me çka ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 para.2 lidhur me par.1 të KPRK-së .

Gjykata në bazë të nenit 41, 45, 47, 73, 75,76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin ,

### E G j y k o n

-Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 90 ( nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë, ashtu që shumën e përgjithshme prej 1500 € do ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në qoftë se dënimi me gjobë nuk do të paguhet atëherë do të ekzekutohet dënimi me burg.

Të akuzuarit koha e kaluar në paraburgim prej datës 12.09.2013-02.10.2013 i llogaritet në shqiptimin e dënimit

-Gjykata në kuptim të nenit 47 të KPRK-së, të akuzuarit me pëlqimin e tij i mundëson që dënimin e shqiptuar me burg efektiv, ta paguaj me të holla.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

### **I akuzuari N.J.**

Është fajtor

Ditën , kohën dhe vendin si në dispozitivin I. Të kësaj aktakuze, me forcë kanë penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, në atë mënyrë që i pandehuri M.K. e ka kapur për jakne zyrtarin policor-tani të dëmtuarin N.V., ndërsa i pandehuri N.J. ka shkuar në drejtim të lartëpërmendurit dhe oficerit tjetër të policisë-tani të dëmtuarit tjetër G.J. dhe kështu i ka penguar të njëjtit në kohën deri sa të njëjtit ishin duke e kryer detyrën e tyre zyrtare- atë të arrestimit të pandehurit të parë A.C. për shkak të sulmit në personat zyrtar.

- me çka në bashkëveprim si bashkëekzekutor kanë kryer veprën penale, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

Andaj gjykata duke u mbështetur në nenin 4,41,50,51,52,73,75 dhe neni 365 të KPPRK-së, të akuzuarit N.J. i shqipton,

## Dënim me kusht

Ashtu që të akuzuarit, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muaj, ekzekutimi i të cilit dënim nuk do të bëhet nëse i akuzuari brenda afatit prej dy (2) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, në rast se i akuzuari kryen veprë tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg

Të dëmtuarit S.S. dhe N.V. nuk parashtruan kërkesës pasurore juridike.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, me aktakuzën PP.nr.1850/2013, të dt.01.10.2013, si në hyrje të aktgjykimit ka akuzuar A.C. nga .... për shkak të veprës penale penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, M.K. dhe N.J. që të dy nga ....., për shkak të veprës penale: në bashkëveprim si bashkekzekutor pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pranë të cilës akuzë ka mbetur deri në fund të shqyrtimit fillestar.

Gjykata konform nenit 36 të KPPRK-së bënë veçimin e procedurës penale për të akuzuarin M.K., pasi i njëjti është i pa arritshëm për gjykatën, andaj për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës procedura penale për të njëjtin do të zhvillohet dhe do të përfundohet ndaras.

I dëmtuari S.S. iu ku bashkangjitur ndjekjes penale, ndërsa nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike për të akuzuarin A.C., për të akuzuarin N.J. nuk iu ku bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore .

I dëmtuari N.V. nuk iu ku bashkangjitur ndjekjes penale për të akuzuarit dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike .

Në shqyrtimin e mbajtur fillestar, përfaqësuesi i akuzës, prokurorja e shtetit Bahtie Ademi të akuzuarëve ia ka lexuar aktakuzën PP.nr.1850/2013 të datës 01.10.2013.

Pas leximit të akuzës nga Prokurorja e Shtetit i akuzuari A.C. e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me akuzën e Prokurorisë së Shtetit në Gjiilan, e ndien vehtënj fajtor,

është penduar thellë për veprën penale, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale, i pa punë, i kërkoi falje publike të dëmtuarve, me të dëmtuarit nuk kanë pasur më probleme, kjo ka qenë krejt e momentit, premtion gjykatës se nuk do të kryejë vepër tjetër penale dhe nuk do të ndeshëm më me ligjin, kërkoi nga gjykata që t'i ketë parasysh të gjitha këto rrethana dhe t'i shqipton një dënim sa më të butë konform ligjit dhe nëse gjykata e sheh të nevojshme t'i shqipton një dënim me burg efektiv të njëjtin dënim t'ia zëvendësojë në dënim me gjobë.

Pas leximit të akuzës nga Prokurori i Shtetit i akuzuari N.J. e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me akuzën e Prokurorisë së Shtetit në Gjilan, e ndien veten fajtor, është penduar thellë për veprën penale, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale, ka gjendjen tejet të vështirë ekonomike, kërkim falje publike të dëmtuarve, ka pasur moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, me të dëmtuarit nuk kanë pasur më probleme, kjo ka qenë krejt e momentit, premtion gjykatës se nuk do të ndeshet më me ligjin, kërkoi nga gjykata që t'i ketë parasysh të gjitha këto rrethana dhe të më shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit.

Meqë të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, gjyqtarja ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kërkesat nga neni 248 parag.1 pika 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4 të KPPRK-së, se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të çështjes që përmban aktakuza dhe se akuza nuk është kontestuar nga të akuzuarit se përmban shkelje ligjore apo gabime faktike.

Andaj gjykata nuk zhvilloi prova në shqyrtim gjyqësor ngase gjendja faktike nuk është kontestuar nga të akuzuarit.

Gjykata me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarve për veprat penale që i kanë kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë, ashtu që gjykata si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin **A.C.** mori: pranimin e fajësisë, sjelljet korrekte në gjykatore, është penduar thellë për veprën penale, premtion se në të ardhmën nuk do të kryejë vepër tjetër penale, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, i pa punë, gjendjes jo të mirë ekonomike, kërkim falje publike të dëmtuarve, me të dëmtuarit kanë raportet e mira më nuk kanë pasur probleme, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin **N.J.** mori: pranimin e fajësisë, sjelljet korrekte në gjykatore, është penduar thellë për veprën penale, premtion se në të ardhmën nuk do të kryejë vepër tjetër penale, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale, kërkim falja publike të dëmtuarit, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, i pa punë, gjendjes jo të mirë ekonomike, kërkim falje publike të dëmtuarve, me të dëmtuarit kanë raportet e mira më nuk kanë pasur probleme, bashkëpunues me

gjykatën, ndërsa nuk gjeti rrethana veçanarisht rënduese për të akuzuarit. andaj gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 90 ditëve, për të akuzuarin A.C. e me mundësi pagimi me të holla është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit në segmentin prevencionit individual dhe gjeneral, ndërsa për të akuzuarin N.J. kjo gjykatë vlerëson se në rrethana të tilla edhe kërcënimi me dënim, është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit në segmentin e prevencionit individual dhe gjeneral.

Të dëmtuarit S.S. dhe N.V. nuk parashtruan kërkesës pasurore juridike.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan-Dega në Kamenicë,

P.nr.371/2013 më date 16.06.2016,

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

\_\_\_\_\_

Emine Zubaku,d.v.

\_\_\_\_\_

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në  
në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi,

Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.